



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 57/6 prot.

Tiranë, më 12.2.2021

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 325, datë 14.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Rilinda Selimi
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datën 28.1.2021, është njoftuar vendimi nr. 325, datë 14.12.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin në rivlerësim znj. Rilinda Selimi, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 28.1.2021, është depozituar akti: “*Rekomandim për paraqitje ankimi*”, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 325, datë 14.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## **I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

**1.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi është gjyqtare prej vitit 2001 dhe aktualisht ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë. Në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, subjekti i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin znj. Rilinda Selimi ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si KLGJ), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të: “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Rilinda Selimi*”, ka referuar:

- i. *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii. *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- v. *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës, ka referuar për subjektin: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*”.

2.3 KLGJ, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 ***Për vlerësimin e pasurisë.*** [...] Në përfundim, duke e vlerësuar kriterin e pasurisë për këtë subjekt rivlerësimi, në tërësinë e tij dhe nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe të objektivitetit, trupi gjykues çmon se pamjaftueshmëria financiare e sipërpërmendur në vlerën totale -505.705 lekë (duke mbajtur në vëmendje edhe rrethanat specifike të përshkruara në paragrafin pararendës nr. 98, si dhe faktin që është e shpërndarë në vite), sikurse pasaktësitë e konstatuara në deklaramet e subjektit nuk përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra të znj. Rilinda Selimi, sipas parashikimeve të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe/ose të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se znj. Rilinda Selimi ka arritur një nivel të besueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, duke justifikuar dhe shpjeguar bindshëm të gjitha pasuritë e analizuar [...].

3.2 ***Për kontrollin e figurës.*** [...] Trupi gjykues mbërrin në konkluzionin se gjatë hetimit administrativ të kryer në mënyrë të pavarur nga Komisioni nuk kanë rezultuar informacione apo fakte që mund të cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, apo elemente të mjaftueshme që mund të përbënin shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, në zbatim të pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 [...].

3.3 ***Për vlerësimin e aftësive profesionale.*** [...] Nga kryerja e një vlerësimi të përgjithshëm të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se, nisur nga gjendja faktiko-ligjore e konstatuar dhe e argumentuar më lart, si dhe nga konstatimet e bëra nga KLGJ-ja, lidhur me mënyrën e të punuarit (*modus operandi*) të subjektit – problematikën që kanë rezultuar lidhur me afatet e përfundimit të shqyrtimeve gjyqësore, nuk mund të klasifikohen si shkelje apo mangësi të rënda profesionale, për më tepër kur ato shpjegohen bindshëm nga subjekti dhe justifikohen nga situata e organikës, *de facto*, të paplotë në institucionin ku ajo kryen funksionin e gjyqtarës. Për rrjedhojë, në konkluzion, trupi gjykues çmon se nisur nga rrethanat e

sipërpërshkruara, subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimeve ligjore përkatëse [...].

4. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur:

- Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.

## II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

5. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c<sup>1</sup>” e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2<sup>2</sup> e ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 28.1.2021, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë: “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 325, datë 14.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit znj. Rilinda Selimi (bashkëlidhur këtij ankimi).

6. Në mënyrë të përmbledhur, objekti dhe çështjet e trajtuara në këtë Rekomandim lidhen me rezultatet e dala nga hetimi administrativ në raport me përfundimet e arritura nga Komisioni, për rivlerësimin e: (i) kriterit të pasurisë; (ii) kriterit të kontrollit të figurës dhe (iii) vlerësimit të etikës/aftësive profesionale.

7. Si konkluzion, ONM-ja rekomandon që procesi i rivlerësimit për znj. Selimi të rishikohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit për të tria kriteret, pasi nga vlerësimi i këtij rasti vërehen disa mangësi:

### 7.1 Për kriterin e pasurisë:

- mungesa e logjikës ekonomike lidhur me të ardhurat e marra përmes kontratave të qirasë të *Pikës së karburantit*;
- mungesa e një analize të plotë të burimit të ligjshëm të pjesës së investuar nga vjehri i subjektit të rivlerësimit, z. \*\*\*.\*\*, në *Pikën e karburantit* - cilësuar si person tjetër i lidhur;
- lidhur me burimet e ligjshme të investimit të ndërtesës 3-katëshe në \*\*\*, Fushë - Krujë;
- mungesa e një hetimi të plotë lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit (155m<sup>2</sup> sipërfaqe e brendshme (neto) + 35 m<sup>2</sup> verandë) në \*\*\*, Tiranë, porositur nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti në vitin 2017, me shoqërinë “\*\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k.;
- mungesa e hetimit lidhur me pasuritë e përdorura nga subjekti i rivlerësimit.

### 7.2 Për kriterin e kontrollit të figurës:

- ekzistenca e rrethanave dhe e indicieve të mjaftueshme, që, për shkak të veçorive dhe burimit nga i cili janë marrë, duhet të vlerësohen në raport me kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, në përputhje me nenin 38, pika 4, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

### 7.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale, çështje etike:

- qëndrimi i subjektit mbi mungesën e detyrimit ligjor për pagimin e taksave, mbi qiratë e marra apo të ardhurat nga shitja e makinave, trajtuar jo në raport me efektet në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, por në drejtim të vlerësimit etiko-profesional të subjektit të rivlerësimit;

<sup>1</sup> Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankimi. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

<sup>2</sup> Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankimi. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

- rezultatet e hetimit administrativ mbi vendimin nr. \*\*\*/2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, të dhënë nga gjyqtarja \*\*\*.\*\*\*, me palë ndërgjygjëse subjektin e rivlerësimit znj. Rilinda Selimi kundër shoqërisë \*\*\*.

**8.** Për sa më sipër është i nevojshëm të kryhet hetim dhe vlerësim i plotë sipas standardeve ligjore dhe financiare të vendosura nga Kolegji mbi çështjet e ngritura në këtë Rekomandim.

**9.** Si përfundim, ONM-ja, bazuar në pikën 2, të nenit 65, të ligjit nr. 84/2016, i ka rekomanduar Komisionerit Publik të ushtrojë ankim mbi të gjithë vendimin nr. 325, datë 14.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi.

### **III. Vlerësimi i Komisionerit Publik**

**10.** Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

**11.** Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

**12.** Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni 4 i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

**13.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

**14.** Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, në vlerësim edhe të rekomandimit të ONM-së, konstaton se nga shqyrtimi i vendimit nr. 325/2020, të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, për të cilat çmon se ky vendim është i cenusshëm në tërësinë e tij, si dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’iu paraqitur juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

**15.** Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës apo i janë kërkuar shpjegime, lidhur me: *(i)* mundësinë për të krijuar të ardhura të ligjshme në shumën 101.000 euro, nga *zoti* \*\*\*.\*\*\*; *(ii)* mundësinë e krijimit të të ardhurave të ligjshme për kursimin e shumës 10.000 euro, nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur; *(iii)* të ardhurat e siguruar nga pasuria “Pika e karburantit”, Vlorë; *(iv)* ndërtesën 3-katëshe në \*\*\*, Fushë - Krujë, me sip. 624 m<sup>2</sup>, aplikuar për legalizim në datën \*\*\*.11.2006, nga vjehri i subjektit të rivlerësimit; *(v)* apartamentin me sipërfaqe 155 m<sup>2</sup> dhe 35 m<sup>2</sup> verandë, ndodhur në \*\*\*, Tiranë, porositur nga subjekti dhe bashkëshorti në vitin 2017; *(vi)* pasuritë në përdorim të subjektit të rivlerësimit: *(I)* automjet “Mini Cooper”, me targë AA\*\*\*, në pronësi të shoqërisë

\*\*\* dhe (2) automjet tip “BMW 535 D”, me targë AA\*\*\*; (vii) kontaktet e papërshtatshme të mundshme të subjektit të rivlerësimit; (viii) qëndrimin e subjektit mbi mungesën e detyrimit ligjor për pagimin e taksave, trajtuar jo në raport me efektet në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, por në drejtim të vlerësimit etiko-profesional; (ix) rezultatet e hetimit administrativ mbi vendimin nr.\*/2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me palë ndërgjygjëse subjektin e rivlerësimit znj. Rilinda Selimi, kundër shoqërisë \*\*, të dhënë nga gjyqtarja \*\*.\*, si dhe (x) ekzistencën e mundshme të gjendjes së konfliktit të interesit në ushtrimin e detyrës.

16. Në referencë të përmbajtjes të pikës 2, të nenit 4, pikës 1, të nenit 59 dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik vlerëson se gjykimi i rrethanave ligjore dhe i fakteve të mësipërme nga ana e Kolegjit është i nevojshëm, duke kryer njëkohësisht një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit.

17. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 325, datë 14.12.2020, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

#### IV. Analiza e shkaqeve të ankimit

##### A. Për vlerësimin e kriterit të pasurisë

18. Pasuria e paluajtshme me nr. \*\*, Zona Kadastrale \*\*, në qytetin e Vlorës, në vijim referuar si: “Pika e karburantit Vlorë”

18.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Pasuria*: Pikë tregtimi karburanti me vendndodhje Vlorë, me sipërfaqe truall 432 m<sup>2</sup> dhe ndërtim 135.25 m<sup>2</sup>, blerë sipas kontratës me rezervë pronësie nr.\*/ rep. dhe nr. \*\* kol., datë \*.5.2013, me shitës \*\* Bank dhe blerës \*\* dhe Shkëlzen Selimi. *Vlera* 250.000 euro, nga kjo shumë prej meje dhe bashkëshortit, si bashkëpronarë të ½ pjesë, është paguar çmimi i blerjes në vlerën 125.000 euro. *Burime financiare*: (i) vlera 69.560 euro, nga kontrata e shitjes së apartamentit në lagjen “\*\*.\*”, Vlorë; (ii) vlera 9.500 euro, nga kontratat e shitjes së garazhit në lagjen “\*\*.\*”, Vlorë; (iii) kursimet nga pagat e mia dhe të bashkëshortit ndër vite, 2.000 euro, dhe vlera e shitjes së automjetit “Mercedes Benz”, 8.000 euro, të depozituara në bankën \*\*.\*; (iv) vlera 10.000 euro, në bankën \*\*, kursime nga pagat e mia dhe të bashkëshortit; (v) shuma 6.600.000 lekë hua nga \*\* Bank, huamarrëse bashkë me bashkëshortin dhe dorëzanës bashkëpronari tjetër, \*\*.\*. *Pjesa takuese* 50% e të gjithë pasurisë, pjesë takuese e imja dhe e bashkëshortit.

18.2 Në DV-2013, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Pasuria*: Kontratë blerje me rezervë pronësie, pikë karburanti me nr. pasurie \*\*, e ndodhur në Vlorë. *Vlera* 250.000 euro. *Pjesa takuese* 25%.

18.3 Komisioni në “Rezultatet e hetimit kryesisht ...”, pas analizës financiare të vitit 2013, vit në të cilin është krijuar pasuria “Pika e karburantit Vlorë”, i ka kaluar subjektit, znj. Selimi, barrën e provës, për të dhënë shpjegime bindëse, lidhur me mungesat financiare të pikës 1.2, më konkretisht se: (i) “bashkëshorti i subjektit së bashku me kredinë e marrë ka paguar shumën prej 149.024 euro, ndërsa vjehri i subjektit ka paguar shumën prej 101.000 euro. Në DIPP 2013 nuk rezulton që të jetë përshkruar saktë shlyerja e vlerës së blerjes të pikës së karburantit, në përputhje dhe sipas përshkrimit të bërë në shkresat e \*\* Bank<sup>[1]</sup>” dhe (ii) “duket se familja e subjektit të rivlerësimit për të kryer këto pagesa në vitin 2013 - që të mbulonin investimin e pjesës takuese të bashkëshortit të subjektit (si bashkëpronar në këtë pasuri) - dhe kryerjen e

[1] Referohuni “Rezultatet e hetimit kryesisht ...”, faqe 8.

shpenzimeve të tjera, ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën - 179.325 lekë”.<sup>[2]</sup>

18.4 Subjekti i rivlerësimit, për barrën e provës, përgjigjet: “...në lidhje me këtë pasuri, sipas relacionit të Komisionit, evidentohet mundësia financiare e bashkëshortit tim dhe babait të tij për të realizuar këtë blerje ...” dhe për problematikat sa më lart cituar, ndër të tjera, përgjigjet se, **lidhur me pikën (i)** “...është e qartë se nga ana ime si subjekt deklarues pranë ILDKPKI është deklaruar çdo shtim apo pakësim në pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme për vitin 2013... Detyrimi i shlyer shitësit kredidhënës është përshkruar në rubrikën përkatëse të detyrimeve, sa ka qenë kredia e marrë në vitin 2013, sa shlyer në këtë vit dhe sa ka mbetur pa shlyer”. **Lidhur me pikën (ii)** “...në arsyetimin e përdorur nga Komisioni në këtë pikë duket që ka konfuzion, pasi provohet qartësisht mundësia e bashkëshortit tim dhe babait të tij për të realizuar këtë blerje dhe të gjitha lëvizjet janë bankare dhe të gjurmueshme/provueshme lehtësisht. Kështu që, ju lutem, të mbani në konsideratë trajtimin e këtyre çështjeve të ndara nga njëra-tjetra”.

18.5 Komisioni ka arritur në këto përfundime: [...] “...Ka pasur burime financiare të ligjshme dhe mundësi kursimi që të krijonte këtë gjendje në llogarinë bankare nga të ardhura të ligjshme që rridhnin nga pagat e punës dhe të transferuara në vijimësi aty.”

“...Ka rezultuar një mjaftueshmëri financiare me burime të ligjshme për të justifikuar shumën e investuar nga z. \*\*\*.\*\*\*, në vitin 2013 (për blerjen e pjesës takuese 50 % të pikës së shitjes së karburantit me pakicë, të cilën ai më tej e ka shitur në favor të shoqërisë së hidrokarbureve “\*\*\*” sh.p.k.”

“...Nisur nga sa është konstatuar lidhur me çdo burim të përdorur për blerjen e pjesës takuese të pasurisë nr. 1, të analizuara në pikat e mësipërme, në një vlerësim të përgjithshëm dhe konkluziv të kësaj pasurie, ka rezultuar se familja e subjektit të rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në vlerën negative prej 179.325 lekësh”.<sup>3</sup>

18.6 **Komisioneri Publik**, në vlerësim dhe të Rekomandimit të ONM-së, vëren se përfundimi i Komisionit nuk është i mbështetur në një hetim të plotë e shterues të situatës faktike të krijimit të kësaj pasurie, si dhe vlerësimit të tyre sipas standardit ligjor të Kolegjit, më së paku në drejtim të dy burimeve të krijimit të pasurisë “Pika e karburantit Vlorë”; (A) mundësia e krijimit të të ardhurave të ligjshme të bashkëpronarit \*\*\*.\*\*\* (në vijim referuar si zoti \*\*\*.\*\*\*), për pagesën e datës \*\*\*.5.2013, në shumën 101.000 euro dhe (B) mundësia e krijimit të të ardhurave të ligjshme për kursimin e shumës 10.000 euro nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, z.\*\*\*.\*\*\*.

18.7 (A) Komisioneri Publik, vlerëson se z.\*\*\*.\*\*\* është person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. Selimi, bazuar në nenin 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, pasi lidhja e interesit rezulton e provuar për shkak të disa rrethanave objektive, që janë: (i) bashkinvestimi në pasurinë “Pika e karburantit Vlorë”, në vitin 2013; (ii) marrëdhënia e konfirmuar e huadhënies midis bashkëshortit të subjektit, znj. Selimi, dhe z.\*\*\*.\*\*\*, në shumën 5.140 euro, zgjidhja e së cilës është deklaruar në DV-2014; (iii) marrëdhënie huadhënie midis bashkëshortit të subjektit, znj. Selimi, dhe z.\*\*\*.\*\*\*, e deklaruar në DV-2017 për shumën 42.500 euro; (iv) vendosja si kolateral, në vitin 2008, i apartamentit 57.1 m,<sup>2</sup> në Krujë, në pronësi të z.\*\*\*.\*\*\*, me qëllim marrjen e huas nga banka \*\*\*, nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj për blerje apartamenti; (v) në kontratën e huas, të nënshkruar në vitin 2013, me \*\*\* Bank, me qëllim pagesën e çmimit të blerjes së Pikës së karburantit, z.\*\*\*.\*\*\* rezulton në cilësinë e

<sup>[2]</sup> Referohuni te “Rezultatet e hetimit kryesisht ...”, faqe 9.

<sup>3</sup> Referohuni respektivisht pikës 39; 113 dhe 43 të vendimit të publikuar të Komisionit.

bashkëdebitorit dhe pasuria në bashkëpronësi të tyre u vendos si kolateral për huan; (vi) bashkëshorti i subjektit, z. Selimi, dhe z.\*\*\*.\*\*\* (vjehtëri i subjektit) kanë dhënë me qira pasurinë “Pika e karburantit Vlorë” dhe të ardhurat e gjeneruara janë depozituar në llogarinë e tyre të përbashkët; (vii) subjekti i rivlerësimit në D-vett. deklaroi z.\*\*\*.\*\*\* si person të lidhur, në seksionin: “Të dhëna për persona fizikë e juridikë, duke përfshirë edhe personin e besuar, që rezultojnë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që mbart detyrimin për deklarim”.

18.7.1 Për sa i përket mundësisë për të krijuar të ardhura të ligjshme në shumën 101.000 euro nga z.\*\*\*.\*\*\*, nga aktet në dosje, rezultojnë këto rrethana faktike që pasqyrojnë gjendjen financiare të z.\*\*\*.\*\*\*, në drejtim të të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën nëntor 2006 - maj 2013.

(i) Gjendja financiare e z.\*\*\*.\*\*\*, ndryshe nga analiza financiare e Komisionit, fillon në nëntor 2006, pasi i vetmi dokument shkresor që jep të dhëna për kohën e përfundimit të investimit për ndërtesën 3-katëshe, \*\*\*, Fushë-Krujë, është vetëdeklarimi për legalizimin, që mban datën \*\*\*.11.2006. Gjithashtu vërejmë se ky vetëdeklarim referon numër kate mbi tokë 1 (një) dhe nën tokë 1 (një), ndërkohë që kartela e pasurisë së paluajtshme e datës \*\*\*.8.2010, për pasurinë (ndërtesë 3-kate, \*\*\*, Fushë - Krujë), rezulton si godinë shërbimi 3-kateshe.

(ii) Nga të dhënat e administruara në dosje të Komisionit, rezulton se burimi kryesor i të ardhurave të z.\*\*\*.\*\*\* janë të ardhurat nga qiraja e pikës së karburantit në pronësi të tij, ndodhur në \*\*\*, Fushë - Krujë. Konkretisht për periudhën dhjetor 2006 deri në maj 2013, kur është paguar *cash* shuma 101.000 euro, shtetasi \*\*\*.\*\*\* ka qenë në një marrëdhënie qiraje më shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe personin fizik \*\*\*.\*\*\*.

18.7.2 Për të ardhurat nga qiraja me shoqërinë \*\*\* sh.p.k. (1) Kontratë qiraje pa akt noterial, datë \*\*\*.4.2006, ndërmjet \*\*\*.\*\*\*, në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, për dhënie me qira me një afat 5-vjeçar, të një pikë karburanti, e ndodhur në fshatin \*\*\*, të rrethit Krujë. Palët kanë rënë dakord se qiraja mujore për vitin e parë do të jetë në shumën 150.000 lekë dhe në vazhdim 180.000 lekë; (2) Kontratë qiraje nr. \*\*\* rep./\*\*\* kol., datë \*\*\*.4.2011, ndërmjet \*\*\*.\*\*\*, në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, për dhënie me qira me një afat 5-vjeçar, të një pike karburanti, e ndodhur në fshatin \*\*\*, të rrethit Krujë. Palët kanë rënë dakord se qiraja mujore do jetë 180.000 lekë.

18.7.2.1 Të ardhurat sipas kontratave të qirasë me shoqërinë \*\*\* sh.p.k., periudhën dhjetor 2006 - maj 2013, janë në total në shumën 12.339.000 lekë, nga të cilat të ardhura të dokumentuara me transaksion bankar në llogarinë e z.\*\*\*.\*\*\*, në \*\*\* Bank, për periudhën tetor 2007- maj 2013 janë në vlerën 10.548.000 lekë. Pagesat e qirasë para tetorit 2007 janë pretenduar të jenë paguar *cash* te qiradhënësi.

18.7.2.2 Ashtu sikurse ka deklaruar dhe subjekti i rivlerësimit, shumat e përfituara nga qiraja me shoqërinë \*\*\* sh.p.k. janë kredituar në llogarinë bankare të z. \*\*\*.\*\*\* (djali i z.\*\*\*.\*\*\*) në \*\*\* Bank, me përshkrimin: “nga \*\*\* sh.p.k, qira...”. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive bankare, rezulton se:

(i) nuk identifikohet ndonjë transaksion bankar, që të lidhë të ardhurat e realizuara nga qiradhënia e pikës së karburantit në \*\*\*, Fushë-Krujë, me shumën e investuar nga z.\*\*\*.\*\*\*, në vlerën 101.000 euro;

(ii) shumat e kredituara në llogaritë të z.\*\*\*.\*\*\* janë tërhequr nga vetë z.\*\*\*.\*\*\*, *cash*, herë pas here;

(iii) një pjesë e këtyre të ardhurave, konkretisht shuma 2.077.500 lekë, është këmbyer dhe vendosur depozitë në emër të z.\*\*\*.\*\*\*, për shumën 15.000 euro. Kjo depozitë ka qenë gjendje

në llogarinë bankare të z.\*\*\*.\*\*\*, në datën \*\*\*.5.2013 dhe nuk rezulton të jetë tërhequr për të mbuluar pagesën 101.000 euro.

18.7.2.3 Përveç sa më sipër, nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive bankare në dosje të Komisionit, konstatojmë se shtetasi \*\*\*.\*\*\*, në datën \*\*\*.5.2013 (*kur është investuar shuma 101.000 euro*) ka pasur depozita në \*\*\* Bank, në vlerën totale 30.000 euro. Gjithashtu konstatojmë se kjo llogari është shtuar me likuiditete të tjera në euro dhe në vijim<sup>4</sup>, në datën \*\*\*.9.2013, shuma e akumuluar në këtë llogari bankare prej 54.700 euro, është transferuar për blerjen e një pasurie të paluajtshme, referuar përshkrimit të transaksionit: *“Trn \*\*\*.\*\*\* blerje pasurie patund. Per rep.\*\*\* kol.\*\*\* dt.\*\*\*.9.13”*.

18.7.2.4 Lidhur me të ardhurat që rrjedhin nga marrëdhënia e qirasë me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., nga aktet e administruara në dosje, vërejmë se nuk konfirmohet nga organet kompetente tatimore<sup>5</sup> pagesa e detyrimeve tatimore për këto të ardhura.

18.7.3 *Për të ardhurat nga qiraja me personin fizik \*\*\*.\*\*\**. Kontratë qiraje nr.\*\*\* rep./ \*\*\* kol., datë \*\*\*.9.2012, lidhur mes z.\*\*\*.\*\*\*, në cilësinë e qiradhënësit dhe z.\*\*\*.\*\*\*, në cilësinë e qiramarrësit, me objekt dhënien me qira të katit përdhe të godinës të ndodhur në fshatin \*\*\*, Fushë-Krujë. Në kontratë parashikohet se qiraja mujore do të jetë 80.000 lekë/muaj, shumë e cila do të paguhet paradhënie për një vit, shumë dhe do të dorëzohet te qiradhënësi në dorë, në një numër llogarie ose më një akt të nënshkruar nga të dyja palët.

18.7.3.1 Lidhur me të ardhurat që rrjedhin nga marrëdhënia e qirasë me p. f. \*\*\*.\*\*\*, nga aktet e administruara në dosje, vërejmë se nuk dokumentohet marrja dhe as shlyerja e detyrimeve tatimore për këto të ardhura.

18.7.4 Përveç sa më sipër trajtuar, nga aktet në dosje, vërejmë se z.\*\*\*.\*\*\* ka realizuar: (i) të ardhura nga shitja e një apartamenti sipas kontratës nr.\*\*\* rep./\*\*\* kol., datë \*\*\*.5.2008, për shumën totale 3.100.000 lekë, nga të cilat ka përfituar pjesën takuese 2.066.667 lekë, (ii) të ardhura nga pensioni i bashkëshortes, si dhe janë pretenduar të ardhura të realizuara nga aktiviteti privat i z.\*\*\*.\*\*\*.

18.7.5 Ndërkohë, lidhur me shpenzimet e jetesës të kryera nga z.\*\*\*.\*\*\*, për periudhën dhjetor 2006 - maj 2013, nga aktet në dosje, konstatojmë se, përveç pretendimit të subjektit për të marrë në analizë të ardhurat e z.\*\*\*.\*\*\*, Komisioni ka llogaritur shpenzime jetese vetëm për 3 persona, ndërkohë që më së paku nga viti 2011, familja e z.\*\*\*.\*\*\*, sipas certifikatës së gjendjes civile, është e përbërë nga 5 anëtarë.

18.7.6 *Sa më sipër referuar, Komisioneri Publik, në vlerësim dhe të Rekomandimit të ONM-së, çmon se duhet kryer një hetim i plotë lidhur me mundësinë e personin tjetër të lidhur, z.\*\*\*.\*\*\*, për të provuar burimin e ligjshëm të shumës 101.000 euro, të investuar në Pikën e karburantit, Vlorë.*

18.8 (B) *Për sa i përket mundësisë së subjektit dhe personit të lidhur, për të krijuar me të ardhura të ligjshme shumën 10.000 euro, që ka shërbyer si burim për pikën e karburantit Vlorë* Subjekti i rivlerësimit, në D.Vett., ka deklaruar si një nga burimet për pasurinë *Pikë e karburantit, Vlorë*, kursimet nga pagat e saj dhe të bashkëshortit ndër vite, 2.000 euro, dhe vlera e shitjes së automjetit “Mercedes Benz”, 8.000 euro, të depozituara në bankën \*\*\*.\*\*\*.\*\*\*.

<sup>4</sup> Referohuni depozitimit *cash* në llogarinë e \*\*\*.\*\*\*, në \*\*\* Bank, të datës \*\*\*.8.2013, me përshkrimin \*\*\*.\*\*\*, dep në llogari, kursime tërhequr nga \*\*\*.\*\*\*.\*\*\* Bank.

<sup>5</sup> Referohuni shkresës DRT Durrës, nr.\*\*\*, datë \*\*\*.11.2019, përmes së cilës ka informuar Komisionin se nuk disponojnë informacion. Subjekti “\*\*\*\*” sh.p.k. është transferuar nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, në DRT, Durrës, me shkresë nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.5.2017.



18.8.1 Nga aktet e administruara në dosje të Komisionit rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, me kontratën nr.\*\*\* rep., \*\*\* kol., datë \*\*\*.7.2011, kanë blerë automjetin tip “Mercedes Benz” kundrejt shumës 900.000 lekë. Në vitin 2012, ky automjet është shitur te shtetasit \*\*\* dhe \*\*\*,\*\*\*, nëpërmjet kontratës së shitjes nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.8.2012, në vlerën 8.000 euro (ekuivalent me 1.117.760 lekë).

18.8.2 Nga informacioni i dërguar Komisionit nga \*\*\*,\*\*\*.\*\*\* Bank konstatohet se, në datën \*\*\*.8.2012, llogaria e subjektit të rivlerësimit pranë kësaj banke është kredituar për shumën 8.000 euro, me përshkrimin: “*derdhje nga \*\*\*,\*\*\*, pagesë për blerje makine*”. Në vijim, kjo shumë bashkë me kursime të tjera të depozituara në këtë llogari bankare, në total shuma 10.000 euro, është kaluar në depozitë. Në datën \*\*\*.8.2013, kjo depozitë është tërhequr *cash* nga llogaria e Rilinda Selimit pranë \*\*\* Bank dhe është depozituar *cash* në të njëjtën datë në llogarinë bankare të \*\*\* Bank, me përshkrimin: “*Blerje pasuri e bankës Shkëlzen \*\*\* Selimi \*\*\**”.

18.8.3 Lidhur me burimin e ligjshëm të blerjes së automjetit tip “Mercedes Benz,” që në vijim ka shërbyer si një nga burimet e pagesës 10.000 euro për blerjen e pikës së karburantit, Komisionit i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2011, në vlerën -386.173 lekë.

18.8.4 Gjithashtu, subjekti është pyetur nëse ishte paguar tatimi mbi të ardhurat e realizuara nga shitja e këtij automjeti në vitin 2012, për shumën 217.760 lekë (1.117.760 - 900.000), si diferencë mes çmimit të shitjes dhe atij të blerjes dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti është shprehur se nuk ka pasur detyrim të paguajë tatim për fitimin e realizuar, pasi ky detyrim nuk ishte parashikuar nga ligji<sup>6</sup>.

18.8.5 Komisioneri Publik, sa më sipër analizuar, konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk mbulojnë plotësisht me të ardhura të ligjshme shumën 10.000 euro, të paguar në favor të \*\*\* Bank, në datën \*\*\*.8.2013, për sa kohë nuk mbulohet plotësisht me burime të ligjshme blerja e këtij automjeti në vitin 2011, si dhe rezulton që nuk janë paguar detyrimet tatimore për fitimin e realizuar nga shitja e këtij automjeti në vitin 2012.

18.9 Në përfundim, Komisioneri Publik, për pasurinë Pika e karburantit, Vlorë vlerëson se, pas administrimit të akteve, në funksion të një hetimi shterues administrativ, Kolegji mund të vlerësojë nëse ka rrethana që do të mund të ngarkonin me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bënte të cenueshëm vendimin e Komisionit lidhur me këtë pasuri, në zbatim të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 dhe 5 e ligjit nr. 84/2016.

## **19. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e pasurisë, Pika e karburantit, Vlorë**

19.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Të ardhura neto të fituara nga qiradhënia e pasurisë, Pika e karburantit, Vlorë, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.a., për periudhën korrik 2013 - shtator 2014; Shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për periudhën tetor 2014 – maj 2015; Shoqërisë “\*\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., për periudhën qershor 2015 në vazhdim, në total shuma 1.736.663 lekë dhe 119.700 euro, si pjesë takuese e subjektit dhe e bashkëshortit në ½ si bashkëpronar.

19.2 Në dosje të Komisionit janë administruar kontratat për dhënien me qira të kësaj pasurie nga viti 2013 e në vazhdim me të dhënat si vijon:

19.2.1 Kontratë qiraje nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.7.2013, ndërmjet Shkëlzen dhe \*\*\* Selimi, në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërive “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh. a., në cilësinë e

<sup>6</sup> Referohuni f.18-19 të vendimit të publikuar të Komisionit.

qiramarrësve me afat 2 vjet. Kjo kontratë është revokuar me dokumentin, revokim kontratë qiraje nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.9.2014.

19.2.1.1 Në nenet 3.1-3.4 të kësaj kontrate specifikohet se: [..] *Qiramarrësi detyrohet t'i paguajë qiradhënësit një qira mujore të përllogaritur në bazë të fitimit mujor dhe, konkretisht, 90% për qiradhënësin dhe 10% për qiramarrësin. Shuma që do të jetë baza e përllogaritjes së përqindjeve si më sipër, është shuma e fitimit neto, që rezulton pas zbritjes nga xhiroja mujore, e të gjitha shpenzimeve, kosto e blerjes së karburanteve, tatimeve dhe taksave; pagesave të punëtorëve dhe partnerëve; shpenzime korente, si drita, ujë, sigurimi i objektit, siguracione etj. dhe çdo shpenzim tjetër i papërcaktuar në këtë kontratë, por i domosdoshëm për kryerjen e aktivitetit tregtar. Nga qiraja mujore e përllogaritur do të mbahet në mënyrë të përafërt dhe dividendi që duhet të paguhet nga qiradhënësi për organet tatimore (brenda muajit mars të vitit pasardhës do të rakordohet shuma që paguhet për organet tatimore dhe përllogaritet dhe diferenca nga njëra palë për t'u paguar palës tjetër)[..].*

19.2.2 Kontratë qiraje nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.10.2014, ndërmjet Shkëlzen dhe \*\*\* Selimi, në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, për dhënie me qira të truallit dhe godinës së pikës së karburantit dhe mjeteve të tjera ndihmëse, me afat \*\*\*.10.2014 – \*\*\*.10.2024. Palët kanë rënë dakord se qiraja mujore do të ketë vlerën 10.000 euro/muaj. Kjo kontratë është revokuar me dokumentin revokim kontrate nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.5.2015.

19.2.3 Kontratë qiraje nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.6.2015, midis Shkëlzen dhe \*\*\* Selimi, në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, me afat nga \*\*\*.6.2015 – \*\*\*.5.2020, me qira në shumën 10.000 euro/muaj. Kjo kontratë nuk rezulton e revokuar dhe transaksionet bankare me përshkrimin: *pagesë qiraje nga shoqëria \*\*\**, rezultojnë deri në dhjetor 2018.

19.3 **Komisioneri Publik**, në vlerësim dhe të Rekomandimit të ONM-së, nga aktet e administruara në dosje të Komisionit, lidhur me këto marrëdhënie qiraje, vëren se:

19.3.1 Nga pikëpamja juridike, kontrata e nënshkruar me shoqërinë \*\*\* sh.p.k., nuk ka elementet tipike të kontratës së qirasë dhe, pavarësisht se është cilësuar nga palët si kontratë qiraje, ajo është një marrëveshje *sui generis*, e cila ka për shkak kryesor funksionin ekonomiko-social. Fakti që pagesa sipas marrëveshjes së palëve kalon çdo muaj, jo domosdoshmërisht e kanalizon marrëdhënien te kontrata e qirasë.

(i) Në këtë situatë, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur e kanë ekspozuar veten ndaj rrezikut që pala tjetër t'i imponojë një fitim më të madh ose më të vogël, në varësi vetëm të dëshirës së saj dhe ky mekanizëm e ekspozon hapur subjektin ndaj rrezikut që ai të bjerë nën ndikimin e palës tjetër, edhe për mënyrën e përmbushjes së detyrave të tij publike. Kolegji, në jurisprudencën e tij, vendimi (JR) nr. 2/2020, ka vlerësuar se marrëdhënie të tilla kontraktuale prodhojnë një mospërputhje thelbësore me funksionin e magjistratit dhe detyrimet në lidhje me etikën.

(ii) Përveç sa sipër trajtuar, nga kontrata fillestare e qiradhënies, e datës \*\*\*.7.2013, me shoqërinë \*\*\* sh.p.k., u vërejt se kapaciteti i pikës së karburantit për të realizuar fitime mujore, varionte nga rreth 300.000 lekë/muaj për vitin 2013, në rreth 228.000 lekë/muaj për vitin 2014.<sup>7</sup> Në këto rrethana, rritja e pagesës mujore të qirasë, nga rreth 2.000 euro/muaj, në 10.000 euro/muaj, për kontratat e qirasë me shoqëritë pasardhëse “\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*”

---

<sup>7</sup> Nga nxjerrja e llogarisë bankare, ku është kredituar qiraja nga shoqëria \*\*\* sh.p.k., rezulton që pagesat mujore të qirasë, që përbëjnë 90% të fitimit, variojnë nga rreth 200.000 - 300.000 lekë/muaj.

sh.p.k., për të njëjtin objekt dhe me të njëjtën veprimtari tregtare, duket si një transaksion i pajustificueshëm ekonomik, i cili shkon kundër logjikës së tregut.

19.3.2 Për më tepër, nga të dhënat financiare të shoqërive qiramarrëse<sup>8</sup>, vërejmë se shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në vitet 2014 dhe 2015, ka deklaruar fitim të realizuar nga aktiviteti në të gjitha pikat e shitjes, përkatësisht 4.251.567 lekë në vitin 2014 dhe 148.849 lekë në vitin 2015. Pra, fitimi i realizuar nga kjo shoqëri në të gjitha pikat e shitjes është shumë i ulët krahasuar me vlerën e qirasë prej 10.000 euro/muaj ose 120.000 euro/vit, që paguan në favor të shtetasve \*\*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*\*.\*\*\*, vetëm për pikën e karburantit në Vlorë.

(i) Në dokumentacionin e administruar në dosje të Komisionit rezultojnë disa kontrata qiraje të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me të tretë, për periudhën 2012-2015. Sipas këtyre kontratave, kjo shoqëri, në cilësinë e qiramarrësit për disa pika karburanti (me vendndodhje në Korçë, Divjakë, Elbasan, Gjirokastrë etj.), paguan qira mujore që varion nga 50.000 lekë – 200.000 lekë/muaj, që dukshëm është shumë më e vogël se qiraja që paguan kjo shoqëri për pikën e karburantit të shitjes në Vlorë, në pronësi të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe z.\*\*\*.\*\*\*.

19.3.3 Lidhur me aktivitetin e shoqërisë “\*\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., konstatohet se kjo shoqëri, gjatë viteve 2015 dhe 2016, ka deklaruar përkatësisht fitim në shumën 4.140.084 lekë për vitin 2015 dhe humbje në shumën -1.324.126 lekë, për vitin 2016. Pavarësisht rezultateve financiare të kësaj shoqërie, rezultojnë që marrëdhëniet e qirasë me shtetasit \*\*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*\*.\*\*\* ka vijuar deri në dhjetor 2018.

19.4 *Komisioneri Publik*, në vlerësim dhe të Rekomandimit të ONM-së, dhe të jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, çmon se këto situata ligjore dhe faktike, parë në vlerësimin tërësor, mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bënte të cenueshëm vendimin e Komisionit, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**20.** *Pasuria e paluajtshme nr.\*\*\*, Zona Kadastrale nr.\*\*\*, në fshatin\*\*\*, Fushë - Krujë, referuar në vijim si pasuria “Ndërtesa 3-katëshe në\*\*\*”*

20.1 Nga aktet e përcjella nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)<sup>9</sup>, ka rezultuar se z.\*\*\*.\*\*\*, ka qenë aplikues në një proces legalizimi për shtesën e një ndërtese trekatëshe me sip. 624 m<sup>2</sup> të ndodhur në \*\*\*\*, Fushë - Krujë. Ky ndërtim rezultoi të jetë në të njëjtën vendndodhje me pikën e karburantit të blerë nga z.\*\*\*.\*\*\* në vitin 1997.

(i) Nga praktika e ASHK-së, rezultoi se shtetasi \*\*\*\*.\*\*\*, me vetëdeklarimin e datës \*\*\*\*.11.2006, ka aplikuar pranë strukturave të Njësisë Vendore për legalizimin e një objekti, me këto të dhëna, numër kate mbi tokë 1 (një) dhe nën tokë 1 (një).

(ii) Me datë \*\*\*\*.7.2009, z.\*\*\*.\*\*\*, ka paguar, pranë \*\*\*\* Bank, vlerën e taksës së infrastrukturës në shumën 171.598 lekë. Vlera e investimit të objektit në proces legalizimi, vlerësuar nga ALUIZNI, për ndërtimin, është në shumën 17.153.760 lekë.

(iii) Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT, Durrës, me lejen e legalizimit nr.\*\*\*, datë \*\*\*\*.9.2009, ka legalizuar objektin me adresë fshati \*\*\*\*, Bashkia Fushë-Krujë, Zona Kadastrale nr.\*\*\*, nr. pasurie \*\*\*\*, sip. parcelës ndërtimore 6 700 m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtimi 187,81 m<sup>2</sup>, numri i kateve 3, sipërfaqe për aktivitet 624.22 m<sup>2</sup>.

20.2 Sa më sipër rezultoi, Komisioni në pyetësin nr. 5, i ka kërkuar subjektit të informojë lidhur me vlerën e këtij investimi, periudhën e ndërtimit, destinacionin e tij, si dhe të paraqesë dokumentacionin përkatës. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësin nr. 5, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...]*Nga shpjegimet e z.\*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*\*.\*\*\*, më është deklaruar se vlera e*

<sup>8</sup> Referohuni komunikimit të Komisionit me Drejtorinë Tatimore, në dosje të Komisionit.

<sup>9</sup> Referohuni fashikullit të ASHK-së, Drejtoria Vendore Krujë, në dosje të Komisionit.

shpenzuar për ndërtimin e objektit ka qenë rreth 14.000.000 (katërbëdhjetë milionë) lekë. Në vitin 2005, për nevoja të zgjerimit të aktivitetit tregtar, si dhe të strehimit, siç do ta shpjegoj më poshtë, vjehri im së bashku me kunatin, z.\*\*\*.\*\*\*, në pamundësi për të marrë leje nga organet kompetente, prishën ndërtesën e vjetër të blerë në vitin 1997 dhe filluan ndërtimin e objektit. Ndërsa ai (ndërtimi) ka përfunduar në fillim të vitit 2006[...].

20.3 Komisioni, në përfundim, lidhur me këtë pasuri, ndër të tjera, ka arritur në këtë përfundim<sup>10</sup> [...]ii. Pasuria në fjalë ekziston prej shumë më herët se subjekti i rivlerësimit të emërohej në detyrë, ndonëse është rikonstruktuar në vitin 2005 – fillim 2006, me kursime të realizuara nga vjehri, përgjatë shumë vitesh, më herët se subjekti i rivlerësimit të martohej, në shtator të vitit 2003; iii. Nuk rezulton që pasuria në fjalë të ketë ndonjë lidhje përfitimi, përdorimi apo bashkëinvestimi nga subjekti i rivlerësimit apo nga familja e saj [...].

[...]Mospërfshirjen e z.\*\*\*.\*\*\* në rrethin e personave të tjerë të lidhur, në cilësinë e dhuruesit apo huadhënësit, të parashikuar nga pika 4 e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, apo si person i lidhur për sa kohë nuk ka jetuar dhe nuk ka qenë ndonjëherë anëtar i familjes së subjektit të rivlerësimit dhe as ka qenë/është i përfshirë në të njëjtën certifikatë familjare me të, vlerëson se në këto kushte kryerja e një analize financiare të mirëfilltë, ex tunc, pa kufizim kohor dhe mbi të gjitha pasuritë e familjes së z.\*\*\*.\*\*\*, në funksion të këtij procesi rivlerësimi, do të ishte e padobishme në kuptimin substancial, pasi do të shkonte përtej kompetencave kushtetuese e ligjore të Komisionit, duke tejkaluar objektin e procesit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, edhe në këndvështrimin procedural, rezultati i arritur nga analiza financiare hipotetike, në çdo rast, nuk do të ishte i përdorshëm me efikasitet dhe në mënyrë legjitime për të ngarkuar me barrë prove apo, për më tepër, me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, edhe nëse do të konstatoheshin problematika apo mangësi lidhur me krijimin, shtesën apo rikonstruktimin e kësaj pasurie. Në të kundërt do të gjendeshim përballë një sforcimi apo interpretimi deformues të frymës së ligjit në raport me rrethanat faktiko-ligjore, çka do të mund të tingëllonte si një fumus persecutionis[...].

20.4 **Komisioneri Publik**, në vlerësim dhe të rekomandimit të ONM-së, si dhe të jurisprudencës të Kolegjit, duke konsideruar lidhjet e interesit të vjehrit të subjektit të rivlerësimit, të z.\*\*\*.\*\*\*, të trajtuara më lart në shkaqet e ankimit, çmon se analiza financiare duhej shtrirë dhe në vlerësimin e mundësisë së z.\*\*\*.\*\*\*, që me të ardhura të ligjshme të mbulojë investimin për pasurinë: “Ndërtesën 3-katëshe në \*\*\*”, duke marrë në vlerësim situatat faktike, për sa në vijim:

(1) Subjekti i rivlerësimit, znj. Selimi, është emëruar në detyrë në nëntor të vitit 2000 dhe ka lidhur martesë ligjore me shtetasin \*\*\*.\*\*\* më datë \*\*\*.9.2003, dhe rezulton të jetë vendosur në përbërjen familjare të bashkëshortit të saj<sup>11</sup>.

(2) Godina objekt legalizimi, e vetëdeklaruar e ndërtuar gjatë viteve 2005-2006, ku ndodhet dhe pika e karburantit të z.\*\*\*.\*\*\*, ka shërbyer si mjet financimi dhe burim i pasurive të krijuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, si dhe i krijimit të marrëdhënieve të interesit me to (për sa trajtuar më lart në shkaqet e ankimit). Sipas përgjigjeve të subjektit, vetëdeklarimit të datës 9.11.2006, si dhe lejes së legalizimit të datës \*\*\*.9.2009, rezulton si ndërtim objekti (shtesë katesh) dhe jo rikonstruksion i ndërtesës.

(3) Z.\*\*\*.\*\*\*, me kontratë shitje nr.\*\*\* rep., \*\*\* kol., datë \*\*\*.12.1997, ka blerë pikë shitje karburanti me pakicë me sip. 950 m<sup>2</sup>, ndodhur në \*\*\*, Fushë-Krujë, në vlerën 9.000.000 lekë; (i) në vitet 2000 dhe 2005 janë blerë 4 pasuri të paluajshme tokë bujqësore, në \*\*\* Fushë-

<sup>10</sup> Referohuni fq. 30 të vendimit të Komisionit, pgr.121 e vendimit.

<sup>11</sup> Referohuni shkresës të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes civile nr.\*\*\* prot, datë \*\*\*.10.2019.

Krujë, me sipërfaqe totale 6.700 m<sup>2</sup>, në vlerën 180.000 lekë; (iv) me anë të kontratës së shitblerjes nr.\*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.11.2001, është blerë apartament në Krujë, në vlerën 1.600.000 lekë.

(4) Në dukje të ardhurat e vjehrrit të subjektit të rivlerësimit janë të pamjaftueshme për të mbuluar vlerën e investimit në shumën 17.153.760 lekë, për të cilën është paguar taksa e ndikimit në infrastrukturë nga z.\*\*\*.\*\*\*, për sa kohë dokumentet provuese të të ardhurave, të dorëzuara nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 4, nuk justifikojnë vlerën e investimit.

(5) Qëndrimi i Kolegjit se, pavarësisht arsytimit mbi proporcionalitetin e hetimit mbi burimin e pasurisë të personave të tjerë të lidhur, në asnjë rast organet e rivlerësimit nuk duhen të pengohen që të hetojnë çdo situatë të dyshuar se personat e tjerë të lidhur mbajnë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit apo se janë përdorur për të fshehur ekzistencën e një marrëdhënieje që të çon në një situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me një person tjetër, dyshim i cili duhet të ngrihet mbi rrethana objektive<sup>12</sup>.

(6) Arsyetimin orientues në vendimin (JR) nr. 21/2020, pgr.76 - 77, mbi qëndrimin tashmë të konsoliduar të jurisprudencës së Kolegjit në trajtimin e çështjeve të ngjashme, ku trupi gjykues ka gjetur me vend të theksojë nevojën për të orientuar Komisionin, në përputhje me nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, që të ndjekë këtë mënyrë arsyetimi në të ardhmen, në drejtim të nevojës për kualifikimet e duhura ligjore të situatave faktike, veçanërisht në funksion të të provuarit të shkaqeve të përdorura për shkarkimin e subjekteve, në lidhje me cilësimin e personit/personave të tretë, si person/persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, apo të marrëdhënies konkrete të subjekteve të rivlerësimit me pasuritë e caktuara.

20.4.1 Sikurse trajtuar më lart në shkaqet e ankimit, nga hetimi administrativ kanë rezultuar një sërë rrethanash që rrjedhin nga interesa pasurore dhe marrëdhënie të tjera biznesi midis familjes së subjektit të rivlerësimit, znj. Selimi dhe babait të bashkëshortit të saj, të cilat në vlerësimin e Komisionerit Publik e kualifikojnë vjehrrin e subjektit të rivlerësimit, si person tjetër i lidhur, në kuptim të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>13</sup>.

20.4.2 Sa më sipër, Komisioneri Publik, në vlerësim dhe të Rekomandimit të ONM-së, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni në vendimin nr. 325/2020, kërkon nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, të cilësojë vjehrrin e subjektit si person tjetër të lidhur dhe, në zbatim të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, të vlerësojë mbi mundësinë e këtij shtetasi për të justifikuar vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

20.4.3 Në këto rrethana, Kolegji do të vlerësonte drejt nëse, në vlerësim tërësor të procedurave, ngrihen dyshime në drejtim të interesave të fshehura të subjektit të rivlerësimit apo ndonjë paligjshmërie tjetër në këtë drejtim, që do të mund të ngarkonte me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bënte të cenueshëm vendimin e Komisionit, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

## 21. Apartamenti me sipërfaqe 155 m<sup>2</sup> dhe 35 m<sup>2</sup> verandë, i ndodhur në \*\*\*, Tiranë, porositur nga subjekti dhe bashkëshorti në vitin 2017

21.1 Gjatë hetimit administrativ, Komisionit i ka rezultuar se subjekti dhe personi i lidhur në DV-2017 ka deklaruar se ka nënshkruar një kontratë sipërmarrjeje, me datë \*\*\*.12.2017, për prenotimin e apartamentit të ndodhur në \*\*\*, Tiranë, nga ku rezulton se në momentin e lidhjes së kontratës ka paguar këstin e parë prej 40.000 euro.

<sup>12</sup> Referohuni vendimit (JR) nr.15/2019, pgr.110; vendimit (JR) nr. 20/2019, pgr. 31.

<sup>13</sup> Referohuni vendimit (JR) nr. 9/2018, pgr.64; vendimit (JR) nr.15/2019, pgr. 107; vendimit (JR) nr. 20/2020, pgr. 21.3.

21.2 Komisioni, në pyetëtorin nr. 5, datë 3.2.2020, i ka kërkuar subjektit të vërë në dispozicion kontratën e sipërmarrjes të datës \*\*\*.12.2017, dokumentacionin që vërteton pagesën e kryer prej 40.000 euro, burimin e ligjshëm të krijimit të tyre, si dhe të informojë nëse ka kryer shpenzime shtesë për arredimin e kësaj pasurie, duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin justifikues përkatës<sup>14</sup>.

21.3 Nga kontrata e sipërmarrjes me nr.\*\*\* rep. /\*\*\* kol., datë \*\*\*.12.2017, lidhur mes subjektit të rivlerësimit, znj. Selimi dhe bashkëshortit, në cilësinë e porositësve dhe shoqërisë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, rezulton se pala Sipërmarrëse merr përsipër t’i dorëzojë Porositësit një apartament, i cili ndodhet në katin nën çati objekti nr.\*\*\*, me konstruksion metalik, sipërfaqe e brendshme neto 155 m<sup>2</sup>, sipërfaqe verandë 35 m<sup>2</sup> dhe t’i kalojë pronësinë Porositësit pas regjistrimit të pronës në ZVRPP, Tiranë. Palët bien dakord që çmimi i shitjes për/m<sup>2</sup> do të jetë 500 euro për apartamentin, si dhe 214,3 euro për verandën, si dhe kanë parashikuar kalendarin e pagesave.<sup>15</sup>

21.4 Komisioni, pasi ka konstatuar se çmimi i apartamentit të porositur prej 500 euro/m<sup>2</sup> (afërsisht 66,475 lekë), rezulton të jetë më i ulët krahasuar me çmimin e tregut të zonës (prej 107,000 lekë/m<sup>2</sup>)<sup>16</sup>, në pyetëtorin nr. 7, të datës 28.7.2020, i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime lidhur me shkaqet e aplikimit të një çmimi më të ulët se çmimet e tregut, si dhe të paraqesë kontrata të ngjashme të lidhura nga e njëjta shoqëri ndërtuese me porositës/blerës të ndryshëm, në të njëjtin objekt/zonë dhe me sipërfaqe të ngjashme me apartamentin e porositur nga ana e subjektit.

21.5 Subjekti, lidhur me çmimin e tregut të lirë për lekë/m<sup>2</sup> ndërtim, në zonën e kësaj pasurie, ka depozituar në Komision shkresën nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.8.2020, të ASHK-së Tiranë, kthyer në përgjigje të kërkesës së subjektit, në të cilën ASHK, ndër të tjera, informon se: [...] *çmimi i referencës në objektin ....në Z. K.\*\*\*, ka qenë 66 500 lekë m<sup>2</sup> [...].*

21.6 Ndërkohë, ASHK, në përgjigje të kërkesës së Komisionit mbi transaksionet e pasurive të paluajtshme tip “apartament”, shitur gjatë vitit 2017 nga shoqëria “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., në fshatin \*\*\*, njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë, përmes shkresës nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.9.2020, ndër të tjera, ka informuar se: [...] *Nuk figuron pasuri, për pasojë, nuk mund të japim informacion në lidhje me transaksionet e pasurive të paluajtshme tip “apartament”, shitur gjatë vitit 2017 nga kjo shoqëri, në fshatin \*\*\*, Njësia Administrative Farkë [...].*

21.7 Subjekti po ashtu, në pyetëtorin nr. 7, ka deklaruar se: [...] *Kjo shoqëri më ka vënë në dispozicion 5 (pesë) kontrata sipërmarrje për prenotim apartamenti, të cilat i ka lidhur me individë të ndryshëm në po atë objekt... Gjithashtu kam siguruar nga banorët e pallatit fqinj dhe 2 (dy) kontrata shitblerje të lidhura nga një subjekt tjetër ndërtues, shoqëria “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k. Këto kontrata janë për shitblerjen e apartamenteve të ndërtuara në të njëjtën periudhë, që ndodhen 50 metra larg në ecuri të së njëjtës rrugë me pallatin ku unë banoj, të cilat tregojnë çmimin e tregut për shitblerjen e apartamenteve në këtë zonë ku unë banoj[...].*

<sup>14</sup> Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr.5, ndër të tjera, ka deklaruar gjithashtu, se në datën \*\*\*.10.2018, në favor të shoqërisë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., ishte likuiduar edhe kësti i dytë në shumën prej 30.000 euro me burim nga të ardhurat e qerasë ndër vite të pronës në bashkëpronësi, pikës së shitjes së karburantit, në masën 1/2 pjesë të tyre. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se me të njëjtin burim financiar si dhe të ardhurat nga punësimi kanë përballuar edhe kryerjen e punimeve shtesë në këtë apartament – sipas aktmarrëveshjes me shoqërinë ndërtuese “\*\*\*” sh.p.k., në vlerën 1.720.000 lekë . Subjekti ka deklaruar se gjatë vitit 2019, ka kryer shpenzime për arredimin, ndriçimin dhe orenditë shtëpiake, lidhur me këtë pasuri, në vlerën prej 24.511 euro dhe 200.000 lekë, me të njëjtin burim të ardhurash financiare si më lart.

<sup>15</sup> Në kontratë është parashikuar dhe kalendarin e pagesave, si: (1) Kësti i parë në shumën 40.000 Euro, është paguar nga shitësi përpara lidhjes së kontratës; (2) Kësti i dytë në shumën 35.000 euro do të paguhet nga porositësi në momentin e dorëzimit të apartamentit; (3) Kësti i tretë në shumën 10.000 euro, do të paguhet nga porositësi në monetin e lidhjes shitblerje të pasurisë objekt kontrate.

<sup>16</sup> Referuar Udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2016”.

21.8 Komisioni, në përfundim, lidhur me kontrollin e pasurive të deklaruara në DV-2017, ndër të tjera, ka arsyetuar se:<sup>17</sup> [...]Për rrjedhojë, përpos luhatjeve të mundshme të dinamikës së tregut të lirë nga Komisioni përgjatë hetimit administrativ – nuk janë gjetur elemente apo rrethana faktiko-ligjore që mund të çonin në hipotetizimin e ndonjë trajtimi preferencial apo çmimi fiktiv, të aplikuar në favor të subjektit të rivlerësimit<sup>18</sup> [...].

21.9 Në vlerësimin e **Komisionerit Publik**, konkluzioni i Komisionit nuk qëndron, pasi nuk bazohet në një vlerësim të drejtë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të dala gjatë hetimit administrativ, si dhe në një zbatim të standardeve ligjore të vendosura, në shqyrtimin e rasteve të ngjashme. Në këto kushte, Komisioneri Publik, në vlerësim dhe të Rekomandimit të ONM-së, çmon se nga Komisioni duheshin marrë në konsideratë, situatat faktike, për sa në vijim:

21.9.1 Referuar praktikave të Kolegjit,<sup>19</sup> për të krahasuar vlerën e blerjes së apartamentit me vlerat mesatare të shitblerjeve të banesave në tregun e lirë për m<sup>2</sup>, sipas Entit Kombëtar të Banesave (në vijim “EKB”), sipas Udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”, konstatohet se vlera mesatare e shitblerjeve, në Njësinë Administrative Farkë, është 66.500 lekë për m<sup>2</sup>. Sikur të përlllogaritim vlerën e shitblerjeve për 188 m<sup>2</sup>, që është sipërfaqja totale e apartamentit sipas planimetrisë, do të kishim një vlerë prej 12.502.000 lekësh ose në euro e konvertuar sipas kursit të dhjetorit të vitit 2017<sup>20</sup> në vlerën 93.725 euro. Nëse kësaj vlere do t’i shtohet dhe vlera e kontraktuar e verandës në vlerën 7.500 euro (35m<sup>2</sup> x 214.3 euro/m<sup>2</sup>) ose 1.000.425 lekë, do kishim një vlerë shitblerje të pasurisë prej 13.502.425 lekë ose 101.225 euro.

21.9.2 Nga kontrata e sipërmarrjes rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur e kanë blerë apartamentin me sipërfaqe të brendshme 155 m<sup>2</sup> dhe verandë 35 m<sup>2</sup>, në vlerën prej 85.000 euro.

21.9.3 Nga aktet e administruara në dosje të Komisionit, mbetet e paqartë vlera e kontratave të shitblerjes nga shoqëria sipërmarrëse në këtë zonë dhe statusi i kësaj shoqërie tregtare në raport me pasuritë e paregjistruara, për sa kohë ASHK, me shkresën nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.9.2020, informon se nuk figurojnë pasuri dhe, për pasojë, nuk mund të japim informacion në lidhje me transaksionet e pasurive të paluajtshme tip “apartament”, shitur gjatë vitit 2017 nga “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., në fshatin \*\*\*, Njësia Administrative Farkë.

21.9.4 Aktet e administruara në dosje të Komisionit, në drejtim të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k. janë depozituar nga subjekti në përgjigje të kërkesës së saj drejtuar gjykatave ku ka ushtruar detyrën dhe i referohen shqyrtimit të çështjeve gjyqësore me palë ndërgjyqjësë shoqërinë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., pa u cilësuar ortaku/administratori i saj.

21.9.5 Kontratat e paraqitura lidhur me çmime të ngjashme të aplikuara nga shoqëria “\*\*\*.\*\*\*” në \*\*\*, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, janë depozituar nga vetë subjekti, pa pasur nga ana e Komisionit një komunikim me shoqërinë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k., në kuptim të nenit 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>17</sup> Referohuni f. 25-26, të vendimit të Komisionit.

<sup>18</sup> Komisioni ka arsyetuar se lidhur me ekzistencën e mundshme të ndonjë konflikti interesash me palën shitëse, nuk kanë rezultuar shqyrtime dhe/ose vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit, lidhur me çështje ku palë mund të kishte qenë shoqëria shitëse apo ortakët/administratorët e saj. Në dosje të Komisionit gjenden të administruara komunikimet me Gjykatat, në përgjigje të kërkesës së subjektit, ku ka ushtruar detyrën subjekti i rivlerësimit, mbi informacionin nëse subjekti ka pasur apo jo shqyrtim gjyqësor me shoqërinë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k.

<sup>19</sup> Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nr. 23/2020 pgr. 28.7; nr. (JR)10/2019, pgr. nr. 13.3; nr. (JR 34/2019), pgr. 67.2 dhe 67.3.

<sup>20</sup> Referuar kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 12.12.2017, euro është konvertuar me 133.39 lekë.

21.9.6 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se, në mënyrë që vendimmarrja mbi këtë pasuri të bazohet vetëm në dokumente nga burime të njohura, në prova të besueshme dhe në pajtueshmëri me provat e tjera, kërkon nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, që:

(1) Të saktësohet informacioni mbi vlerën e kontratave të shitblerjes të realizuara nga shoqëria “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k. në Njësinë Administrative Farkë dhe mbi statusin e kësaj shoqërie në raport me pasuritë e paregjistruara, duke administruar të dhëna nga vetë shoqëria “\*\*\*.\*\*\*” apo burime të njohura dhe zyrtare.

(2) Të administrohet informacion nëse në gjykatat në të cilat ka ushtruar detyrën subjekti i rivlerësimit ka pasur ose jo çështje gjyqësore me palë ndërgjyqëse ortakun/administratorin e shoqërisë “\*\*\*.\*\*\*” sh.p.k.

21.9.7 Pas administrimit të akteve në funksion të një hetimi shterues administrativ, Kolegji mund të vlerësojë nëse ka rrethana që do të mund të ngarkonin me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bënte të cenueshëm vendimin e Komisionit lidhur me këtë pasuri sipas përkufizimit të “pasurisë”, dhënë nga neni 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, në zbatim të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 dhe 5 e ligjit nr. 84/2016.

22. Pasuritë në përdorim të subjektit të rivlerësimit: (1) automjet “Mini Cooper”, me targë AA\*\*\*, në pronësi të subjektit \*\*\* dhe (2) automjet tip “BMW 535 D”, me targë CX\*\*\*, në pronësi të kunatit të subjektit të rivlerësimit, z.\*\*\*.\*\*\*<sup>21</sup>

22.1 1) Automjet “Mini Cooper”, me targë AA\*\*\*

22.1.1 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjes nr. 5 të pyetësorit, nr.1 të Komisionit, nëse ka përdorur në shtatë vitet e fundit pasuri të regjistruara në emrin e dikujt tjetër, ka deklaruar: [...] Automjet i markës “Mini Cooper”, me targë AA\*\*\*, në pronësi të subjektit “\*\*\*”, me aktivitet të autorizuar në shitjen e automjeteve. Ky automjet është përdorur vetëm për udhëtime të familjes jashtë shtetit për periudhën 2014-2016, me pëlqimin e porositesit për blerjen e automjetit, z.\*\*\*.\*\*\*, i cili është babai i bashkëshortit. Z.\*\*\*.\*\*\*, në momentin e lidhjes së kontratës (me rezervë pronësie), më datë \*\*\*.1.2013, nuk ka kryer pagesën për vlerën/çmimin e plotë të automjetit të sipërcituar. Për këtë shkak dhe referuar përcaktimeve të Kodit Civil, automjeti ishte në pronësi të subjektit “\*\*\*”, me të drejtën e blerësit për përdorimin e tij. Marrëdhënia si më sipër mes palëve “\*\*\*” dhe z.\*\*\*.\*\*\* ka zgjatur deri në vitin 2016, ku për shkak të mosmarrëveshjeve civile, palët janë kthyer në gjendjen e mëparshme dhe automjeti i është dorëzuar shitësit pronar “\*\*\*”, në muajin tetor 2016[...].

22.1.2 **Komisioneri Publik** konstaton se, pas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, si më lart cituar, Komisioni nuk ka mbajtur një qëndrim apo hetuar më tej mbi rrethanat e deklaruara nga vetë subjekti, rrethana të cilat, në vlerësim dhe të Rekomandimit të ONM-së, kanë nevojë për t’u qartësuar në drejtim të:

(1) administrimit të kontratave të lidhura nga z.\*\*\*.\*\*\* me shoqërinë “\*\*\*”, për të kontrolluar vlerën e paguar nga z.\*\*\*.\*\*\*, për automjetin *Mini Cooper*, në drejtim dhe të analizës financiare mbi mundësinë e vjehrrit që me të ardhura të ligjshme të krijojë pasurinë e tij;

(2) burimit të ligjshëm të të ardhurave të vjehrrit të subjektit të rivlerësimit;

(3) hetimit të mundshëm të konfliktit të interesit midis subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “\*\*\*”.

22.1.2.1 Në këto kushte, pas administrimit të akteve në funksion të një hetimi shterues administrativ, Kolegji mund të vlerësojë nëse ka rrethana që do të mund të ngarkonin me

<sup>21</sup> Referohuni Rekomandimit të ONM-së në f.7, germa e).



përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bënte të cënueshëm vendimin e Komisionit, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës.

## **22.2 (2) Automjet tip “BMW”, modeli 535 D**

22.2.1 Referuar pyetësorit nr. 6, në dosje të Komisionit, rezulton se emri i subjektit të rivlerësimit figuron si përdoruese e autoveturës *BMW modeli 535D*, me nr. shasje \*\*\*, dhe me targë AA\*\*, prodhim i vitit 2005, në policën me nr.\*\*, të lëshuar nga shoqëria “\*\*\*”, për periudhën \*\*.6.2011 - \*\*.6.2012.

22.2.2 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 6, ndër të tjera, ka deklaruar se: *[...]Lidhur me faktin që citoni... unë nuk kam pasur dijeni. Në kuadër të procesit të rivlerësimit, bashkëshorti im më ka sqaruar se sigurimin TPL e ka kryer shtetasi \*\*.\*\*, si pronari i automjetit, nga ku rezulton se ka vendosur dhe emrin tim si përdorues potencial [...].*

22.2.3 DPSHTRR, me shkresën nr.\*\* prot., datë \*\*.7.2020, në përgjigje të kërkesës së Komisionit,<sup>22</sup> për t’i vënë në dispozicion kontratat e shitblerjes të automjetit me nr. shasje \*\*, tipi, BMW, modeli 532 D, ngjyra metalizato, viti i prodhimit 2005, si dhe pronarët që rezultojnë gjatë gjithë muajve të vitit 2011, ka informuar se: *[...] Mjeti me nr. shasje \*\*, nuk figuron i regjistruar në DPSHTRR [...].*

22.2.4 **Komisioneri Publik**, në vlerësim dhe të Rekomandimit të ONM-së, për sa kohë mjeti nuk figuron i regjistruar në DPSHTRR dhe nga polica e sigurimit rezulton se në cilësinë e pronarit të automjetit është kunati i subjektit të rivlerësimit, z.\*\*.\*\*, vlerëson se Komisioni duhej të hetonte më tej dhe të qartësonte disa situata, në drejtim të:

(1) *çmimit të blerjes së pasurisë automjetit tip “BMW 535 D”, me targë CX\*\*;*

(2) *burimit të ligjshëm të blerjes;*

(3) *kontratës së shitblerjes dhe palëve në kontratë.*

22.2.4.1 Në këto kushte, pas administrimit të akteve në funksion të një hetimi shterues administrativ, Kolegji mund të vlerësojë nëse ka rrethana që do të mund të ngarkonin me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bënte të cënueshëm vendimin e Komisionit, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

## **IV.B. Për vlerësimin e kruterit të figurës**

23. *Për kriterin e kontrollit të figurës. Komisioni ka administruar nga DSIK-ja raportin me nr.\*\* prot., datë \*\*.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, me të cilin ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi.*
- 23.1 Komisioni, me vendimin nr. 2, datë 15.1.2020, vendosi të mos administronte materiale të dosjes së hetimit të kryer nga një tjetër trup gjykues gjatë procedurës së rivlerësimit të z.\*\*.\*\*, bashkëshortit të subjektit të znj. Rilinda Selimi, por të kryente një hetim të pavarur, të thelluar dhe gjithëpërfshirës lidhur me të gjitha faktet dhe rrethanat që do të vlerësoheshin të nevojshme për rivlerësimin e znj. Rilinda Selimi.<sup>23</sup>
- 23.2 Komisioni, me qëllim kryerjen e një hetimi sa më të thellë dhe gjithëpërfshirës, nisur nga disa të dhëna publike, ka ndërmarrë disa hapa të mëtejshëm hetimorë në mënyrë të pavarur, duke kryer konkretisht verifikime dhe kërkuar shpjegime lidhur me disa persona, me të cilët edhe subjekti i rivlerësimit mund të kishte pasur kontakte apo marrëdhënie shoqërore dhe/ose profesionale.
- 23.3 Komisioni, ndër të tjera, ka arsyetuar se: *[...] Nisur nga disa rrethana publike, që mund të hidhnin hije dyshimi mbi kontakte të mundshme të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit...,*

<sup>22</sup> Referohuni shkresës nr.\*\* prot., datë \*\*.6.2020, drejtuar DPSHTRR-së.

<sup>23</sup> Referohuni f.3 të vendimit të Komisionit.

përfshirë këtu edhe të dhënat e konstatuara në disa elemente të përmbajtjes së vendimit nr. 3/2019 (JR), të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit..., siç ishte gjetja e emrit të subjektit si një përdoruese e mundshme, në policën e sigurimit (TPL) të një automjeti tip “BMW” modeli 353D – Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 6, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit që të jepte shpjegime lidhur me përdorimin e mundshëm të këtij automjeti, si dhe mbi ekzistencën e mundshme të ndonjë marrëdhënieje personale apo familjare, frekuentimi, kontaktimi me pronarin e automjetit de quo dhe/ose me shtetasin \*\*\*,\*\*\*, i cili rezultonte se ishte ndaluar në ngarje e sipër të këtij automjeti, më \*\*\*.11.2011 – për sa kohë rezultonte e provuar dhe e pranuar se shtetasi \*\*\*,\*\*\* kishte pasur marrëdhënie të hershme dhe njohje prej shumë vitesh me bashkëshortin e subjektit [...].<sup>24</sup>

23.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 6, ndër të tjera, ka deklaruar: [...] *Deklaroj se unë nuk e kam përdorur këtë automjet as si drejtues dhe as si pasagjer. ...Shtetasi \*\*\*,\*\*\* dhe familja e tij ishte njohje e bashkëshortit tim dhe jo e imja. Për disa rrethana objektive gjatë jetesës në qytetin e Vlorës: qenia në të njëjtin kopsht dhe shkollë të djalit tim me djalin e këtij shtetasi, banesa në të njëjtën lagje; unë kisha informacion për familjen e tij dhe përshëndetje rastësore me të, fëmijët dhe bashkëshorten e tij[...].*

23.5 Komisioni, pasi ka arsyetuar mbi sa ka deklaruar subjekti dhe nga sa ka rezultuar gjatë hetimit administrativ<sup>25</sup>, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *Në vijim dhe, për rrjedhojë të sa është konstatuar, përshkruar dhe arsyetuar më lart, trupi gjykues mbërrin në konkluzionin se përgjatë hetimit administrativ të kryer në mënyrë të pavarur nga Komisioni nuk kanë rezultuar informacione apo fakte që mund të cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi apo elemente të mjaftueshme që mund të përbënin shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, në zbatim të pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

23.6 **Komisioneri Publik**, në vlerësim dhe të Rekomandimit të ONM-së, çmon se konkluzioni i Komisionit nuk qëndron, pasi nuk bazohet në një vlerësim të drejtë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të dala gjatë hetimit administrativ, në një zbatim të drejtë të ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

23.6.1 Lidhur me vlerësimin e kriterit të figurës së subjektit të rivlerësimit, ashtu sikurse e cituam më lart, qëndrimi i Komisionit, ishte që për efekte të procesit të rivlerësimit, në rastin konkret, të mos administronte materiale të dosjes së hetimit të kryer nga një tjetër trup gjykues gjatë rivlerësimit të bashkëshortit të subjektit Rilinda Selimi, por të kryente një hetim të pavarur të thelluar dhe gjithëpërfshirës lidhur me të gjitha faktet dhe rrethanat që do të vlerësoheshin të nevojshme për rivlerësimin e znj. Rilinda Selimi.

23.6.2 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, për sa kohë nuk u administrua informacion nga organet ligjzbatuese për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit, znj. Selimi, Komisioni, në zbatim të kompetencave kushtetuese dhe në referim të nenit 38, pika 4, duhej të analizonte rrethanat ligjore që cilësojnë ekzistencën e një kontakti të papërshtatshëm<sup>26</sup>, në

<sup>24</sup> Referohuni f.32 të vendimit të Komisionit, pgr.127.

<sup>25</sup> Referohuni f.33-36 të vendimit të Komisionit, pgr. 131-135.

<sup>26</sup> Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, janë kur:

- a) subjekti i rivlerësimit është fotografuar ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
- b) subjekti i rivlerësimit ose **personi i lidhur me të** ka pasur një komunikim jorastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
- c) subjekti i rivlerësimit ose **një person i lidhur me të** ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

kushtet kur për personin e lidhur të saj, bashkëshortin z.\*\*\*.\*\*\*, rezulton i provuar kontakti i papërshtatshëm me persona të përfshirë me krimin e organizuar.

23.6.3 Komisioneri Publik vlerëson se verifikimi/analizimi i rrethanave, është jo vetëm një kërkesë ligjore, por gjithashtu mbështetet dhe në dy vendime të publikuara të institucioneve të rivlerësimit, që lidhen me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, z.\*\*\*.\*\*\*, për sa vijon:

(i) Vendimi nr. 52/2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lënë në fuqi me vendimin (JR) nr. 3/2019, të Kolegjit të Apelimit, i referohet marrëdhënieve miqësore familjare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me shtetasin \*\*\*.\*\*\*, një person i dënuar penalisht disa herë. Specifikisht në vendimin nr. 52/2018 të Komisionit<sup>27</sup>, lidhur me marrëdhënien e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me shtetasin \*\*\*.\*\*\*, parashikohet se z. Shkëlzen Selimi ka deklaruar se: *[...]Siç ju shpjegova ne kemi hyrje - dalje familjare të cilën e ruajmë pavarësisht ndryshimit të vendbanimit të familjes sime nga Vlora, prej vitit 2011. Ne takohemi, duke përfshirë: festat familjare, ditëlindjet, përvjetorët, pushime verore, me personin ose edhe familjarisht. Në disa raste kemi udhëtuar jashtë shtetit të dy, dhe në një rast me familjet, në Gjermani, në dhjetor të vitit 2013. Sikundër e kam shpjeguar edhe gjatë komunikimit elektronik, me shtetasin \*\*\*.\*\*\*, kam njohje shoqërore, e cila ka filluar rreth vitit 2005, kur kemi qenë banorë të së njëjtës lagje “\*\*\*.\*\*\*”, në qytetin e Vlorës, dhe ka vijuar deri kur unë dhe familja ime jemi transferuar në Tiranë për arsye pune. Pas kësaj kohe, duke filluar nga shtatori i vitit 2011 kontaktet tona janë rralluar, duke u takuar vetëm në rastet e pushimeve apo ditëlindjeve [...].*

(ii) Në vendimin e publikuar nr. (JR) 3/2019 të Kolegjit të Apelimit, parashikohet se: *[...] Gjatë hetimit të zhvilluar nga Komisioni, nëpërmjet analizës së të dhënave të marra nga agjencitë ligjzbatuese, por edhe nga përgjigjet e dhëna nga vetë subjekti, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka një miqësi të gjatë me këtë shtetas dhe familjen e tij. Ai vetë ka pohuar gjatë kthimit të përgjigjeve në pyetësor (me email-in e datës 13.2.2018) se marrëdhënia e tyre është familjare, e shëndoshë dhe afatgjatë, që prej 13 vitesh, kur ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë. Subjekti e cilëson shembullor këtë shtetas dhe familjen e tij. Ai ka shprehur përgjatë gjithë përgjigjeve të dhëna në Komision se e vlerëson mënyrën e jetesës së këtij shtetasi dhe familjes së tij, të cilën e ka atashuar pranë të vetes pikërisht për shkak të këtyre arsyeve (pgr. 59) [...].<sup>28</sup> Këto rrethana të publikuara mbështeten dhe në prova të tjera, si polica e sigurimit, nën emrin e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit, polica që u gjenden në makinën me të cilën shtetasi \*\*\*.\*\*\* po udhëtonte, në kohën kur u ndalua nga policia për armëmbajtje pa leje (pgr. 66-69 vendimi nr. (JR) 3/2019, i Kolegjit të Apelimit).*

23.6.4 Po ashtu, kontakti i papërshtatshëm i bashkëshortit, personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, është e provuar përtej çdo dyshimi nga gjetjet e ONM-së, të cilat, në kuptim të nenit 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, i cili ekziston ose ka ndodhur, të barasvlershme me mendimin e dhënë nga një ekspert.

(i) Në vendimin nr. (JR) 3/2019 të Kolegjit, pgr.71, parashikohet se: *[...] Emri i shtetasit \*\*\*.\*\*\* dhe marrëdhënia e tij me subjektin e rivlerësimit Shkëlzen Selimi ka rezultuar e*

---

d) subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, e publikuar ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës. \*Rrethanat e mësipërme janë shprehimisht të përcaktuara, në ligjin nr. 84/2016, ashtu sikurse ligji parashikon se mund të analizohen në kushtet e rrethanave lehtësuese të parashikuara nga neni 38, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

<sup>27</sup> <https://kpk.al/wp-content/uploads/2018/09/Vendim-Shkelzen-Selimi-i-azhornuar.pdf>

<sup>28</sup> <http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-nr.3-date-07.02.2019-subjekti-i-rivleresimit-Shkelzen-Selimi-per-publikim-2.pdf>

provuar nga “gjetja” e paraqitur nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, në kuptim të nenit 49, paragrafi 10, i ligjit nr. 84/2016. Shtetasi \*\*\*.\*\*\* rezulton të jetë ndjekur penalisht nga autoritet italiane të drejtësisë për veprën penale: “Pjesëmarrje në organizatë kriminale, me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike”, e cila përfshihet te parashikimet e nenit 3, pika 1 e ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin e goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, për pasojë në kuptim të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, ky shtetas konsiderohet si person i përfshirë në krimin e organizuar. Në kuptim të kësaj dispozite, vlera provuese e kësaj prove është ajo e një akti ekspertimi, pra një provë e cila me vështirësi mund të vihet në dyshim për vlerën e saj provuese nga çdo trup gjykues që do të duhet ta vlerësojë, pikërisht për shkak të veçorive të saj dhe burimit nga i cili është marrë. Ky i fundit, për shkak të nivelit të besueshmërisë, integritetit dhe paanësisë e profesionalizmit, vlerësohet se ka vlerë të veçantë krahas natyrës tepër specifike të mënyrës së mbledhjes së informacionit. Sipas kësaj gjetjeje, subjekti i rivlerësimit jo vetëm që ka lidhje të qëndrueshme me shtetasin \*\*\*.\*\*\*, por ai ka përdorur influencën e tij në sistemin e drejtësisë, qoftë nëpërmjet vendimeve të tij të drejtpërdrejta, por edhe ndikimit te funksionarë të tjerë që ekstradimi i këtij shtetasi drejt shtetit italian, në vitin 2014, të dështojë [...].

23.7 **Komisioneri Publik**, në përmbledhje të sa më sipër, në vlerësim dhe të rekomandimit të ONM-së, për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, çmon se në rastin konkret, në kushtet kur ekzistojnë dy vendime të institucioneve të rivlerësimit, si dhe një gjetje e ONM-së, janë rrethana dhe indicie të mjaftueshme, që për shkak të veçorive dhe burimit nga i cili janë marrë duhet të zhvillohet kontrolli i figurës bazuar në kërkesat e nenit 38 të ligjit nr. 84/2016.

#### **IV.C. Për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale**

24. Në vlerësim dhe të Rekomandimit të ONM-së, Komisioneri Publik do të ndalet mbi çështje të rezultuara gjatë hetimit administrativ, që lidhen me vlerësimin e kriterit të aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit.
25. *Qëndrimi i subjektit mbi mungesën e detyrimit ligjor për pagimit e taksave, trajtuar, jo në raport me efektet në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, por në drejtim të vlerësimit etiko-profesional*
- 25.1 Referuar përmbajtjes së vendimit nr. 325/2020, konstatojmë se disa çështje të lidhura me pagesën e detyrimit tatimorë mbi: (i) qiratë e marra apo të (ii) ardhurat nga shitja e makinave janë trajtuar nga Komisioni për qëllime të analizës financiare, ndërkohë që duket se ka dhe rrethana të tjera që lidhen me çështje etike dhe profesionalizmi.
- (i) Nga aktet në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit ka dhënë me qira apartamentin dhe një garazh për vitet 2011-2013. Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se gjatë vitit 2013, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, në \*\*\* (sot \*\*\* Bank) ka vijuar të derdhet shuma e qirasë prej 2.200 euro në total, deri në muajin maj, por nuk rezulton që për këto të ardhura të vitit 2013 të jenë paguar detyrimet tatimorë.
- (ii) Në DV-2003, subjekti ka deklaruar : (I) pronësinë mbi Automjetin të markës “Fiat”, me targë TR\*\*\*, në vlerën 600.000 lekë. Referuar kontratës së shitjes,<sup>29</sup> me datë \*\*\*.10.2003, çmimi i blerjes së këtij automjeti nga subjekti i rivlerësimit është 250.000 lekë. Rezulton se ky automjet është shitur me Kontratën e shitjes<sup>30</sup> të datës \*\*\*.7.2011, me vlerën rreth 691.500

<sup>29</sup> Kontrata e shitjes me nr.\*\*\* rep. dhe nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.10.2003, me vlerë 250.000 lekë.

<sup>30</sup> Kontrata e shitjes nr.\*\*\* rep. dhe nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.7.2011, shitur me vlerë 5.000 euro.

lekë<sup>31</sup> (ose prej 5.000 euro); (2) Ndërsa gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në vitin 2012, ka blerë autoveturën tip “Mercedes Benz”, me targa AA\*\*\* nëpërmjet kontratës nr.\*\*\* rep./\*\*\* kol., datë \*\*\*.7.2011, kundrejt çmimit prej 900.000 lekësh. Subjekti i rivlerësimit, në vitin 2012, ka shitur këtë mjet nëpërmjet kontratës së shitjes nr.\*\*\* rep./\*\*\* kol., datë \*\*\*.8.2012, me vlerën rreth 1.117.760 lekë (8.000 euro). Sa më sipër, lidhur me pagesën e tatimit mbi të ardhurat e realizuara si diferencë mes çmimit të shitjes dhe atij të blerjes, ka rezultuar që për këto të ardhura nuk janë paguar detyrimet tatimore.

25.2 Komisioni, për sa më sipër rezultuar, ndër të tjera, ka përfunduar se: [...] *Të ardhurat për të cilat nuk është shlyer detyrimi financiar nuk mund të konsiderohen në analizën financiare, por rrethanat specifike të sipërcituara do të çmohen në raport me peshën dhe pasojën që mund të passjellë pamjaftueshmëria financiare e mundshme*<sup>32</sup>[...].

25.3 **Komisioneri Publik**, në vlerësim dhe të rekomandimit të ONM-së, çmon se rezultatet e hetimit mbi mungesën e pagesës së detyrimeve tatimore për të ardhurat nga qiraja dhe nga diferenca e shitblerjes së dy automjeteve, për sa më sipër trajtuar, nuk duhen analizuar vetëm në drejtim të efektit të mospagesës së këtij detyrimi tatimor në rezultatet e analizës financiare, por në drejtim të vlerësimit etiko-profesional të subjektit të rivlerësimit.

(i) Subjekti i rivlerësimit për qiratë e realizuara nga apartamenti në Vlorë ka pretenduar se nuk ka qenë në dijeni të mospagesës së detyrimeve tatimore, për periudhën janar – maj 2013<sup>33</sup>, ndërsa për detyrimet tatimore të ardhurave të realizuara nga shitja e 2 (dy) makinave, subjekti ka bërë me dije se nuk ka pasur asnjë detyrim për të paguar, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar<sup>34</sup>.

24.3.1 Komisioneri Publik, në vlerësim dhe të Rekomandimit të ONM-së, çmon se përgjigjet e subjektit duhen vlerësuar në drejtim të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, për shkak të njohurive ligjore që duhet të ketë subjekti, duke qenë se është gjyqtare e Gjykatës Administrative të Apelit, juridiksioni i së cilës përfshin shqyrtimin e vendimeve me objekt legjislacionin tatimor, por edhe në kuptim të domosdoshmërisë për të qartësuar pozitën e saj në raport me zbatimin e ligjit në lidhje me këto të ardhura.

26. *Rezultatet e hetimit administrativ mbi vendimin nr.\*\*\*/2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me palë ndërgjyqëse subjektin e rivlerësimit znj. Rilinda Selimi kundër shoqërisë \*\*\* , të dhënë nga gjyqtarja \*\*\*.\*\*\**

26.1 Komisioni ka hetuar mbi disa fakte dhe rrethana të publikuara në linkun: [https://\\*\\*\\*.\\*\\*\\*.tv/2018/06/11/gjyqtarja-30-mije-euro-demshperblim-se-i-anuluan-viziten-ne-cirkun-kinez/](https://***.***.tv/2018/06/11/gjyqtarja-30-mije-euro-demshperblim-se-i-anuluan-viziten-ne-cirkun-kinez/). Në përmbajtje të këtij informacioni mediatik ka referenca lidhur me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*\*.2.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë paditëse znj. Rilinda Selimi etj., dhe me palë të paditur shoqërinë “\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*”. Gjykata ka vendosur: “Pranimin e padisë, detyrimin e shoqërisë “\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*”, dega Shqipëri, të dëmshpërblejë dëmin pasuror që rrjedh nga parapagimi i shërbimit ndaj të paditurit, më datë \*\*\*.3.2016, sipas kontratës me kod prenotimi \*\*\* , për pagimin e shërbimit të transportit sipas 5 biletave të transportit ajror vajtje- kthim të paditësve, në vlerën prej 913.26 euro, si dhe

<sup>31</sup> Konvertuar me kursin mesatar të fundit të vitit 2011, ku 1 euro këmbehej me 138.3 lekë.

<sup>32</sup> Referohuni f.13 të vendimit të Komisionit.

<sup>33</sup> Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në nenin 13 parashikon se në rast se qiramarrësi që paguan shumën e qirasë është individ, detyrimin për deklarimin e të ardhurave të siguruara nga qiradhënia dhe pagesën e tatimit e ka vetë qiradhënësi, person fizik (individ).

<sup>34</sup> Referohuni pyetësorit nr. 2 dhe pikës 58, të vendimit të publikuar të Komisionit.

*dëmin jopasuror në vlerën 30.000 euro, për shkak të mospërmbushjes së kontratës së transportit ajror në favor të paditësve”.*<sup>35</sup>

26.2 Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr.\*\*\*, datë \*\*\*.6.2017, ka vendosur: “Prishjen e vendimit gjyqësor nr.\*\*\*, datë \*\*\*.2.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate me një tjetër trup gjykues. Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs nga subjekti i rivlerësimit dhe dosja ndodhet në Gjykatën e Lartë, regjistruar me nr.\*\*\*, me status – studim çështje<sup>36</sup>.

26.3 Komisioni, për sa ka rezultuar nga përmbajtja e informacionit mediatik, aktet e administruara dhe deklarimet e subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, ka çmuar se: [...] *Në këto kushte, trupi gjykues, ndonëse ka hetuar dhe analizuar këtë situatë në kuadër të një hetimi administrativ sa më të thelluar e gjithëpërfshirës – duke mos mundur të vlerësojë themelin e çështjes (bazueshmërinë e padisë civile dhe termat sasiorë), nuk gjen ndonjë rrethanë, fakt apo veprim ose mosveprim të subjektit që mund të krijojë lidhjen shkak-pasojë të sa është shprehur më sipër me kristalizimin e ndonjë përgjegjësie të znj. Rilinda Selimi, për sa kohë e drejta për të paraqitur një padi civile, kur dikush ndihet i dëmtuar, nuk mund t’i mohohet askujt [...].*<sup>37</sup>

26.4 **Komisioneri Publik**, në vlerësim dhe të Rekomandimit të ONM-së, çmon se rezultatet e hetimit mbi të metat procedurale dhe materiale të vendimit nr.\*\*\*/2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë<sup>38</sup>, duheshin konsideruar nga institucionet e rivlerësimit, në drejtim të perspektives së një trajtimi preferencial në drejtim të znj. Selimi si gjyqtare dhe, nëse në *prima facie*, ky vendim të jep përshtypjen e një vendimi të paarsyeshëm, që ngre dyshime mbi një pabarazi përballë ligjit<sup>39</sup>.

26.4.1 Në këto kushte, nëse ky rast do ishte hetuar si duhej (duke krahasuar këtë vendimmarrje me raste të tjera të përcaktimit të dëmit jo pasuror), mund të rezultonte se gjyqtari nuk mori në konsideratë praktikën gjyqësore dhe realitetin ekonomik-social në Shqipëri, duke dhënë një vendim të paarsyeshëm në drejtim të paditësve Rilinda Selimi dhe të tjerët.

26.4.2 Në këto situata faktike të pasurisë, *Pikës së karburantit, Vlorë*, dhe të kontratave atipike të qirasë të lidhura me të, çmimi i shitjes më i lartë se çmimi i blerjes së makinave, qiraja e apartamentit në Vlorë, më shumë se dyfishi i qirasë së paguar në mes të qytetit të Tiranës, mospagimi i detyrimeve tatimore, vendimi gjyqësor i paarsyeshëm në favor të subjektit, i cili për më tepër dhe u ankimua kur u kthye për rigjykim, mund të jenë rrethana të një trajtimi preferencial, që tregojnë influencën e subjektit të rivlerësimit në qarkullimin civil, krahasuar me qytetarët e tjerë<sup>40</sup>.

<sup>35</sup> Referohuni shkresës nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, dhe akteve bashkëlidhur. Nga aktet e administruara konstatohet se shtetasit \*\*\*,\*\*\*, \*\*\*,\*\*\*, \*\*\*,\*\*\*, \*\*\*,\*\*\* dhe \*\*\*,\*\*\* kanë paditur në Gjykatën e Shkallës së Parë, shoqërinë “\*\*\*\* \*\*\*,\*\*\*,\*\*\*” s.p.a, me objekt: “Shpërbllim dëmi pasuror dhe jopasuror shkaktuar paditësve për shkak të mosekzekutimit nga i padituri, pa shkak ligjor dhe në mënyrë të padrejtë, të kontratës së transportit ajror”.

<sup>36</sup> Referohuni shkresës nr.\*\*\*, datë \*\*\*.12.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

<sup>37</sup> Referohuni pikës 217, të vendimit të publikuar të Komisionit.

<sup>38</sup> Vënë në dukje dhe nga vendimi i Gjykatës së Apelit.

<sup>39</sup> (i) Duket se shumica e dëmit të pësuar nuk është specifikuar nga paditësi në kërkesë padi (pavarësisht se është kërkesë ligjore); (ii) Legjitimitimi i palëve duket se ka të meta, për sa kohë fluturimi nuk lejohej për 3 fëmijë, ndërkohë që gjyqtari e mori të mirëqenë, që të pesë paditësit ishin të legjitimuar për të ngritur padi; (iii) Të paditurit kanë bërë një kërkesë për të caktuar një ekspert IT, për të mundësuar vlerësimin e Termave dhe Kushteve të Përgjithshme në faqen web të \*\*\*. Kjo kërkesë nuk u konsiderua nga gjyqtari dhe në vendim nuk u arsyetuan arsyet e këtij refuzimi; (iv) Eksperti i caktuar për llogaritjen e dëmeve të shkaktuara është një vlerësues i dëmeve të shkaktuara nga sigurimet dhe Gjykata nuk konsideroi të merret një ekspert psikolog, për të përcaktuar për çfarë dëmsh bëhej fjalë; (v) Aplikimi i gabuar i vendimit unifikues nr.12 të datës 14.9.2007, mbi çfarë do të konsiderohet dëm jopasuror dhe cilat janë kriteret e përcaktimit të tij.

<sup>40</sup> Referohuni pikës 102 të Komentarit shpjegues të parimeve të Bangalores: [...] *Duhet të kihet parasysh se si sjellje të caktuara mund të perceptohen nga anëtarë të arsyeshëm, me mendje të drejtë dhe të informuar të komunitetit, dhe nëse një perceptim i tillë ka të ngjarë të zvogëlojë respektin e komunitetit për gjyqtarin ose gjyqësorin në tërësi. Sjellja të tilla, që kanë të ngjarë të zvogëlojnë respektin në mendjet e personave të tillë, duhet të shmangen [...].*

26.4.3 Komisioneri Publik, në vlerësim dhe të Rekomandimit të ONM-së, çmon se këto situata ligjore dhe faktike, parë në vlerësimin tërësor, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, mund të çojnë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.<sup>41</sup>

27. *Ekzistenca e mundshme e gjendjes së konfliktit të interesit në ushtrimin e detyrës*

27.1 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka pyetur subjektin e rivlerësimit, nëse, gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës<sup>42</sup>, ka shqyrtuar çështje gjyqësore si gjyqtare e vetme apo anëtare e trupës gjyqësore, ku si palë ndërgjyqëse kanë qenë apo janë: persona fizikë, persona juridikë, shoqëri, palë shitëse, palë blerëse, përdorues, qiramarrës, qiradhënës, huamarrës, huadhënës apo sipërmarrës, të lindur me nga çfarëdo lloji marrëdhënie interesi, gjatë gjithë periudhës të ushtrimit të aktivitetit si gjyqtar, si dhe i ka kërkuar të paraqesë dokumentacion provues.

27.1.1 Në përgjigje të pyetësorit nr. 5, datë 3.2.2020, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: [...] *Ju bëj me dije se, përgjatë gjithë periudhës të ushtrimit të funksionit tim si gjyqtare, nuk kam shqyrtuar çështje gjyqësore si gjyqtare e vetme apo anëtare e trupës gjyqësore, ku si palë ndërgjyqëse të kenë qenë persona fizikë, persona juridikë, shoqëri, palë shitëse, palë blerëse, përdorues, qiramarrës, qiradhënës, huamarrës, huadhënës apo sipërmarrës, të lidhur me mua nga çfarëdo lloji marrëdhënie interesi [...].*

27.1.2 Nga aktet e vëna në dispozicion nga subjekti konstatohet se Gjykata Administrative e Apelit, me shkresën nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.8.2020, drejtuar subjektit të rivlerësimit, ka informuar se janë në total pesë çështje të shqyrtuara nga ana e subjektit të rivlerësimit si relatores/anëtare e trupës, nga të cilat katër me Shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe një me Shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.

27.1.3 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 7, ka deklaruar se: [...] *Në vijim, në lidhje me subjektet “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe \*\*\* sh.p.k. 43, referuar përgjigjes së Gjykatës Administrative të Apelit, vë në dukje se nuk kam qenë në asnjë rast në gjendje papajtueshmërie, sikurse normon neni 72 i Kodit të Procedurës Civile. Koha e marrjes pjesë në përbërje të trupit gjykues në gjykimet e përfunduara është pas përfundimit të marrëdhënies së qirasë mes babait të bashkëshortit, z.\*\*\*.\*\*\* [...].*

27.2 Komisioni, për sa më sipër, ka përfunduar se: [...] *Komisioni pasi ka trajtuar rastet e mësipërme, në kuadër të detyrimit të subjektit të rivlerësimit sipas dispozitave të K. Pr. Civile, ligjit nr. 9367/2005, për parandalimin e konfliktit të interesave dhe në referencë të jurisprudencës të GJEDNJ-së, arriti në përfundimin se, për sa kohë marrëdhënia e qirasë midis babait të bashkëshortit të subjektit rivlerësimit dhe shoqërive tregtare ka përfunduar shumë kohë më parë nga pjesëmarrja e saj në trupën gjykuese, si dhe për sa kohë nuk provohet se ajo ka gjykuar çështje gjyqësore në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 72-73 të K. Pr. Civil, vlerësojmë se subjekti ka provuar dhe shpjeguar në mënyrë të mjaftueshme se nuk ka gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit [...].*

<sup>41</sup> Këto situata, jashtë ushtrimit të profesionit të subjektit të rivlerësimit, duhet të shihen në përputhje me praktikën e mira të njohura gjerësisht dhe të gjithëpranuara të parimeve të Bangalores mbi sjelljen e magjistratit. Në pikën 4.9 të parimeve të Bangalores parashikohet se: [...] “Një gjyqtar nuk duhet të përdorë apo të cenojë prestigjin e postit të gjyqtarit për interesa private të tij apo të një anëtari të familjes së tij, apo të kujtdo tjetër, dhe as nuk duhet të krijojë përshtypjen apo të lejojë të tjerët të krijojnë përshtypjen se kushdo me pozitë të veçantë ndikon padrejtësisht në punën e tij gjatë ushtrimit të profesionit”.

<sup>42</sup> Në të gjitha gjykatat ku ka ushtruar detyrën si gjyqtare e deri aktualisht, duke përfshirë edhe komandimet e mundshme.

<sup>43</sup> Nuk ka asnjë gjykim për asnjë nga personat e tjerë, përgjatë gjithë ushtrimit të veprimtarisë sime si gjyqtare.

**27.3 Komisioneri Publik** vlerëson se përfundimet e Komisionit nuk janë bazuar nga aktet në dosje, si dhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Apelit, mbi trajtimin e rasteve të ngjashme mbi identifikimin e konfliktit të interesit. Nga aktet në dosje rezulton se çështja me palë paditëse shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr.\*\*\* akti, datë \*\*\*.11.2014, periudhë në të cilën marrëdhëniet e qirasë të z.\*\*\*.\*\*\* me këtë shoqëri vazhdonin, gjë që konfirmohet dhe nga të dhënat e llogarisë bankare të shtetasit \*\*\*.\*\*\*, kunatit të subjektit, në të cilën i kanë kaluar qiratë mujore nga kjo shoqëri.

